



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCË SHKENCORE

Lasgush Poradeci



**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË**

NË BASHKËPUNIM ME:

**AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË
INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS
INSTITUTIN E GJUHËSISË DHE LETËRSISË, AKADEMIJA E
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË
INSTITUTIN E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP**

ORGANIZOJNË

KONFERENCËN SHKENCORE KOMBËTARE

“ LASGUSH PORADECI NË 120-VJETORIN E LINDJES ”

Lasgush Poradeci
25 tetor 2019

**SALLA E KONFERENCAVE “TEODOR LAÇO”, FAKULTETI I EDUKIMIT DHE
FILOLOGJISË, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË**



Konferenca Shkencore: **“LASGUSH PORADECI NË 120-VJETORIN E LINDJES”** organizohet nga Universiteti “Fan S. Noli” (Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë - Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, me qëllim rivlerësimin dhe nderimin që i bëhet një prej figurave më të shquara të letërsisë dhe kulturës shqiptare, me rastin e 120- vjetorit të lindjes.

Lasgush Poradeci është cilësuar si poeti i parë modern shqiptar dhe liriku më i madh shqiptar i shekullit XX. Poezia e tij solli një ndjeshmëri të re, një kërkim të thellë gjuhësor e formal dhe një figurë të paparë në letërsinë shqipe. Me Lasgush Poradecin, lirika shqiptare mund të konsiderohet si një dukuri evropiane për nga niveli i ligjërimit poetik origjinal. Ai paraqitet si poet me shpirt modern dhe evropian. Tek universi poetik i L. Poradecit hasim si të rrallëkush në poezinë shqipe, një magji të pastër të gjuhës shqipe, të forcave magjike të tingujve që japin thirrjet e jetës. Poezia e Lasgush Poradecit është krijuesja e një imazhi kombëtar nga pikëpamja gjuhësore, idilet e përmallshme të një jete të pastër, mendimet filozofike, këngët për vendlindjen. Gjuha shqipe është vetëdija e ndërvoja e tij dhe e gjithë kombit shqiptar. Kjo figurë e përmasave të mëdha vjen në 120-vjetorin e lindjes së tij me madhështinë që e karakterizon, duke u hapur rrugë të reja studimeve shkencore, për të ndriçuar dhe analizuar aspekte të shumta që i sugjeron vepra e tij poetike.

Lasgush Poradeci



Konferenca do t'i zhvillojë punimet në këto drejtime:

- **Aspekte të jetës dhe veprimtarisë së Lasgush Poradecit**
- **Krijimtaria letrare e Lasgush Poradecit**
- **Lasgush Poradeci dhe poezia europiane**
- **Lasgush Poradeci si përkthyes**

Tema orientuese:

- Poezia filozofike e Lasgush Poradecit
- Poezia e dashurisë (konceptimi i ndjenjës dhe figurës femërore)
- Ndikimi i Lasgushit nga poezia popullore
- Mjeshtëria e vargut dhe muzikaliteti i poezisë
- Fjalori poetik dhe gjuha e Lasgushit
- Shkrimet publicistike, kritike dhe vetjake të Lasgushit
- Lasgushi dhe kolonia shqiptare e Bukureshtit
- Lasgushi dhe artet

Dita e mbajtjes së konferencës: **25 tetor 2019**, Salla e Konferencave “Teodor Laço”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë.

Afati përfundimtar për dorëzimin e përmbledhjeve: 15 korrik 2019

Pranimi/refuzimi i përmbledhjeve: 25 korrik 2019

Publikimi i programit të konferencës: 15 tetor 2019

Përmbledhjet dorëzohen në adresën elektronike: konferencauniko@yahoo.com

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e temave bashkë me përmbledhjet, Komiteti Shkencor i Konferencës do të bëjë përzgjedhjen e temave dhe harton programin e punës.



KOMITETI SHKENCOR

Prof. dr. ALI JASHARI, Universiteti i Korçës

Akad. FLORESHA DADO, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

Prof. dr. HYSEN MATOSHI, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë

Prof. dr. VALTER MEMISHA, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Prof. dr. SHABAN SINANI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

Prof. dr. QEMAL MURATI, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë

Prof. SKENDER ASANI, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup

Prof. as. dr. JONELA SPAHO, Universiteti i Korçës

KOMITETI ORGANIZATOR

Prof. as. dr. Elona Biba (Çeçe)

Prof. as. dr. Dion Tushi

Dr. Ilir Shyta

Msc. Neli Naço

Msc. Olger Brame (koordinatori i konferencës)

Lasgush Poradea



MODELI I PËRMBLEDHJES

Të interesuarit duhet të dërgojnë përmbledhjen në gjuhën shqipe. Temat e propozuara duhet të jenë hulumtime origjinale dhe të papublikuara më parë. Ato duhet të dërgohen në formë elektronike në e-mail-in e caktuar.

Formati i faqes: A4. Margjinat: lart e poshtë: 2,5 cm; djathtas e majtas: 2.5 cm

TITULLI I PUNITIT: (14 pt Times New Roman, Bold, i qendëruar, me shkronja të mëdha (UPERCASE))

PËRMBLEDHJA (deri në 250 fjalë; 12pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5)

EMRI/AT E AUTORIT/ËVE (Me shkronja të mëdha, 12 pt Times New Roman, në qendër). Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12 pt Times New Roman, në qendër)

E-MAIL (për komunikim) 12pt Times New Roman, në qendër, i rrafshuar në të dy skajet.

FJALËT KYÇE: 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (12pt Times New Roman, Normal)

Për pjesëmarrësit në konferencë nuk do të ketë tarifë regjistrimi